



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
INSPEKTORATI SHTETËROR I MBIKËQYRJES SË TREGUT

# ANALIZË PUNE PËR VITIN 2022



Tiranë 2023

## PËRMBAJTJA

<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJA</b> .....	3
<b>II.</b>	<b>HYRJE</b> .....	3
2.1	Misioni.....	3
2.2	Detyrat .....	3
2.3.	Struktura .....	4
<b>III.</b>	<b>QËLLIMI DHE METODOLOGJIA</b> .....	4
<b>IV.</b>	<b>ARRITJE TË ISHMT-SË</b> .....	5
<b>V.</b>	<b>RAPORTIMET SIPAS DREJTORIVE</b> .....	6
5.1	<b>DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË PRODUKTEVE JOUSHQIMORE (DMP)</b> .....	8
5.1.1	Inspektimi Metrologjik.....	8
5.1.2.	Produkte elektrike.....	9
5.1.3.	Produkte mekanike .....	9
5.1.4	Qelq/këpucë/lodra & siguria e përgjithshme.....	10
5.2	<b>DREJTORIA E PRONËSISË INTELEKTUALE</b> .....	13
5.2.1	Inspektimi mbi të drejtën e autorit.....	14
5.2.2	Inspektime mbi pronësinë industriale.....	14
5.3	<b>DREJTORIA TEKNIKE (DT)</b> .....	15
5.4.	<b>DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE</b> .....	17
<b>VI.</b>	<b>PUBLIKIME &amp; AKTIVITETE SENSIBILIZUESE</b> .....	20
<b>VII.</b>	<b>PROBLEMATIKA TË HASURA</b> .....	22
<b>VIII.</b>	<b>KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME</b> .....	23
<b>IX.</b>	<b>OBJEKTIVAT PËR VITIN 2023</b> .....	24
<b>X.</b>	<b>ANEKS</b> .....	26

## **I. PËRMBLEDHJA**

Raporti mbi veprimtarinë e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) përmban në mënyrë të përmbledhur një analizë të punës së kryer nga ky institucion për vitin 2022, duke përfshirë inspektimet mbi kontrollin e zbatimit të kriterëve ligjore nga subjektet, sipas fokusit të çdo sektori/drejtorie , aktivitetet sensibilizuese, informuese, trajnime e seminare. Gjithashtu në këtë raport janë paraqitur edhe problemet me të cilat është përballur ISHMT-ja gjatë këtij viti, ku, mund të përmendim si më të rëndësishme për mbarëvajtjen e përditshme të punës: mungesa e mjeteve të transportit, mungesë eksperience e stafit, etj., ndërsa për sa i përket procesit të inspektimit , evident ka qenë mos plotësimi i planit të inspektimit me 15% për shkak të angazhimit të ISHMT-së në fusha të reja inspektimi të diktura nga situata të vecanta si: monitorimi dhe inspektimi i çmimeve të karburanteve të vendosura nga Bordi i Transparencës, monitorimi dhe inspektimi i qeseve plastike mbajtëse me veshë si dhe i problemeve të shkaktuar nga sulmet kibernetike.

Në këtë raport janë paraqitur edhe rekomandime për përmirësimin e punës dhe të marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërinstitucional që do të ndikojnë në rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së punës së këtij institucioni dhe të një mirëkoordinimi me institucionet e tjera publike, grupet e interesit dhe operatorët ekonomikë.

## **II. HYRJE**

### **2.1 Misioni**

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) është një institucion qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për tregtinë dhe me seli në Tiranë<sup>1</sup>.

ISHMT-ja ka për mision garantimin e sigurisë së produkteve për konsumatorët, të vendosura në treg dhe në shërbim/në përdorim, nëpërmjet aktiviteteve mbikëqyrëse sipas legjislacionit përkatës në fuqi. ISHMT-ja është, gjithashtu, përgjegjëse për të monitoruar respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe të drejtave të tjera sipas fushës së veprimtarisë institucionale, objekt inspektimi sipas këtij vendimi.

### **2.2 Detyrat**

Në zbatim të VKM-së nr.36 datë 20.01.2016 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHMT”, fushat e përgjegjësisë së ISHMT-së janë si mëposhtë:

- a) mbrojtja e konsumatorëve, sipas përcaktimit të ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve;
- b) mbrojtja e pronësisë industriale, sipas përcaktimit të legjislacionit për pronësinë industriale;

---

<sup>1</sup> VKM Nr.36, datë 20.01.2016 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHMT”.

- c) garantimi i mbrojtjes dhe i respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, sipas përcaktimit të legjislacionit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to;
- ç) inspektimi metrologjik, sipas legjislacionit për metrologjinë;
- d) etiketimi për konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, sipas përcaktimit të legjislacionit për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji;
- dh) kontrolli i detergjentëve të vendosur në treg sipas dispozitave të ligjit për detergjentët;

### 2.3.Struktura

ISHMT-ja organizohet si Drejtori e Përgjithshme me juridiksion në të gjithë territorin e vendit. Struktura dhe organika e re e ISHMT-së është miratuar me Urdhërin e Kryeministrit nr.73, datë 01.06.2020 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”.

ISHMT-ja përbëhet nga 4 drejtori:

1. Drejtorja Teknike
2. Drejtorja e Mbikëqyrjes së Produkteve
  - 2.1.Sektori i Produkteve Elektrike
  - 2.2.Sektori i Inspektimit Metrologjik
  - 2.3.Sektori i Produkteve Mekanike
  - 2.4.Sektori Kimik dhe i Sigurisë së Përgjithshme
3. Drejtorja e Pronësisë Intelektuale
  - 3.1.Sektori i Pronësisë Industriale
  - 3.2.Sektori i të Drejtës së Autorit
4. Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse
  - 4.1. Sektori Juridik dhe Shërbimeve Mbështetëse
  - 4.2.Sektori i Financës

## III. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

### I.1 Qëllimi

- ✓ Ndjekja e procedurave të inspektimit me rigorozitet dhe konform legjislacionit në fuqi.
- ✓ Evidentimi i pikave të dobëta në punën e ISHMT-së duke krijuar premisa për marrjen e masave për përmirësimin e tyre në të ardhmen.
- ✓ Evidentimi i risqeve dhe marrja e masave për minimizimin ose eliminimin e tyre.
- ✓ Evidentimi i problematikave, marrja e masave dhe nxitja e mekanizmave për zgjidhjen e tyre duke rritur cilësinë e punës së këtij institucioni.

### I.2 Metodologjia

Metodologjia e ndjekur për hartimin e këtij raporti mbi punën e kryer nga ISHMT-ja për vitin 2022 bazohet në :

- ✓ Analizën e raporteve periodike të dorëzuar nga çdo sektor në lidhje me punën e kryer në terren (inspektime), problematikën e hasur dhe sugjerimet për përmirësimin në vazhdimësi;
- ✓ Përpunimin e statistikave të mbledhura mbi inspektimet e kryera nga inspektorët gjatë kësaj periudhe kalendarike ;
- ✓ Feedback-un nga aktorë të ndryshëm (publikë, privatë, ndërkombëtarë) me përvojë dhe eksperiencë në fushat që janë në fokusin e punës së ISHMT-së;
- ✓ Analizën e procedurave të inspektimeve, të performancës, proceseve gjyqësore, trajtimit të ankesave etj ;
- ✓ Analizën e trajtimit në kohë dhe me profesionalizëm të ankesave të depozituara pranë ISHMT-së nga konsumatorë, operatorë ekonomike apo institucione shtetërore.

#### IV. ARRITJE TË ISHMT-SË

- ✓ Ndikimi në uljen e mos-konformiteteve të produkteve joushqimore si dhe në respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale nëpërmjet inspektimeve të kryera gjatë vitit 2022. Inspektimet e vazhdueshme dhe të rregullta në treg, të shoqëruara nga fushata sensibilizuese, kanë ndihmuar në përpjekjet institucionale për të arritur këtë objektiv. Janë kryer në total **2569 inspektime** nga të cilat 2322 inspektime të programuara<sup>2</sup> dhe 247 jashtë programit mbi bazë ankimi<sup>3</sup>. Janë vendosur **372 masa administrative në total** nga të cilat 74 paralajmërime, 258 gjoba dhe 40 masa urgjente (bllokim, shkatërrim). Janë kontrolluar **11059 produkte** nga të cilat 848 produkte kanë qenë jo në konformitet.
- ✓ Angazhimi i ISHMT-së në monitorimin dhe inspektimin e subjekteve për zbatimin e çmimit tavan të miratuar nga Bordi i Transparencës në zbatim të Aktit Normativ Nr.5 datë 12.03.2022 “Për disa shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” dhe Aktit Normativ Nr.8, datë 25.3.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin transportimin dhe tregtimin e naftës së gazit dhe nënprodukteve të tyre” dhe Aktit nr.7 datë 18.03.2022 “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg”. Në lidhje me monitorimin e çmimeve të karburanteve dhe të ushqimeve të vendosur nga Bordi i Transparencës nga ISHMT në këtë periudhë janë realizuar **832**

<sup>22</sup> “Inspektim i programuar” është inspektimi që kryhet në bazë të programit të miratuar të inspektimit për çdo inspektorat qendror apo vendor

<sup>3</sup>Inspektim jashtë programit konsiderohet inspektimi kur: a)nga monitorimi dhe mbikëqyrja e kryer nga inspektorai , nëpërmjet analizës periodike dhe të vazhduar të të dhënave apo informacioneve, lind dyshimi i arsyeshëm për shkeljen e kërkesave ligjore; b) ndodhja e ngjarjeve, aksidenteve apo incidenteve kanë cenuar apo mund të cenojnë jetën ashëndetin e njerëzve, kafshëve apo mjedisin; c) si pasojë e informacionit të marrë nga një institucion publik shqiptar apo një shtet tjetër a njëorganizatë ndërkombëtare.; d) në bazë të një denoncimi apo informacioni të marrë nga të tretët, nëse krijohet dyshimi i arsyeshëm për shkelje të kërkesave ligjore nganjë subject; e)në kushtet e flagrancës; etj.

**inspektime dhe monitorime.** Në zbatim të Aktit normativ Nr.5 datë 12.03.2022 janë vendosur **17 masa administrative gjobë.**


- ✓ Angazhimi i ISHMT në monitorimin dhe inspektimin e tregut në lidhje me ndalimin e qeseve plastike që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në VKM nr.367, datë 20.5.2022 “ Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit, apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme”. Janë kryer në total **2354 monitorime dhe inspektime për qeset plastike.** Janë vendosur **4 masa administrative** nga të cilat 1 gjobë, 3 masa ndalim tregtimi dhe si rezultat janë sekuestruar 187 kg qese plastike jokonform.
- ✓ Bërja e evidente të ISHMT-së në tregun e produkteve joushqimore dhe në fushën e respektimit të pronësisë intelektuale, si një institucion që ka në fokus kontrollin e respektimit të kriterëve ligjore sipas fushës së veprimtarisë së tij. Informimi i operatorëve ekonomikë, konsumatorëve ka qenë gjithashtu në fokusin e punës së ISHMT-së nëpërmjet përditësimit të vazhdueshëm të informacioneve në web-site: [www.ishmt.gov.al](http://www.ishmt.gov.al), rrjetet sociale, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.
- ✓ Informimi i konsumatorëve mbi të drejtat e tyre për të disponuar produkte/pajisje/instalime të sigurta dhe informimin e operatorëve ekonomikë, për të respektuar kërkesat ligjore të përcaktuara në legjisllacionin aktual, për të ofruar në treg produkte të sigurta si dhe për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Kjo është arritur nëpërmjet aktiviteteve, trajnimeve të ndryshme të organizuar me pjesëmarrjen e grupeve të interesit, të botimeve dhe shpërndarjes së fletëpalosjeve, botimeve informuese, emisioneve, intervistave televizive, etj. Në total janë realizuar **20 aktivitete sensibilizuese.**
- ✓ Fuqizimi i ISHMT-së dhe rritja e kapaciteteve njerëzore. Gjatë kësaj periudhe janë kryer në total **15 trajnime ku janë trajnuar 50 punonjës** në fushën e mbikëqyrjes së tregut dhe të pronësisë intelektuale. Trajnimet janë mbështetur nga donatorë të ndryshëm.
- ✓ ISHMT ka dhënë kontributin në hartimin e: 4 (katër) draft VKM, 1(një) draft ligji, 3(tre) marrëveshje bashkëpunimi, 1 (një) draft strategji dhe në raportimet për Kapitullin 1, 7 dhe 28 si pjesë e GNP. Janë përpiluar 1 rregullore, 2 udhëzime dhe 2 metodologji.

## V. RAPORTIMET SIPAS DREJTORIVE

Në total nga ISHMT gjatë kësaj periudhe janë kryer **2569 inspektime** nga të cilat **2322 inspektime të programuara dhe 247 jashtë programit mbi bazë ankese dhe nga aktivitetet monitoruese .** Janë vendosur **372 masa administrative** në total nga të cilat **74 paralajmërime, 258 gjoba dhe 40 masa urgjente (bllokim, shkatërrim).** Janë kontrolluar **11059 produkte** nga të cilat **848 kanë qënë jo në konformitet.**

ISHMT ka realizuar 2569 inspektime në total nga të cilat Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve (DMP) ka realizuar 2095 inspektime dhe Drejtoria e Pronësisë Industriale (DPI) ka realizuar 457 inspektime (Tab.1). Referuar Planit vjetor të inspektimeve 2022 ISHMT ka realizuar 85 % të totalit të inspektimeve të planifikuara në Planin e Inspektimeve për vitin 2022 (Tab.2).

Realizimi sipas sektorëve paraqitet në grafikun e mëposhtëm ku Sektori Metrologjik ka realizim prej 101 %, Sektori i Produkteve Elektrike me 93 %, Sektori i Produkteve mekanike me 86 %, Sektori Kimik me 68 % dhe Sektori i të Drejtave të Autorit me 51%. Sektori i Pronësisë Industriale me ndryshimet në ligjin e pronësisë industriale dhe me futjen e inspektimeve ex-officio ka realizuar 107 inspektime nga 50 inspektime të pa programuara që kanë qenë planifikuar në Planin e Inspektimeve për vitin 2022.



Mosrealizimi me 15% i inspektimeve të planifikuara lidhet me angazhimin e ISHMT-së gjatë vitit 2022 si më poshtë:

☞ Për monitorimin dhe inspektimin e subjekteve për zbatimin e çmimit tavan të miratuar nga Bordi i Transparencës në zbatim të Aktit Normativ Nr.5 datë 12.03.2022 “Për disa shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” dhe Aktit Normativ Nr. 8, datë 25.3.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin transportimin dhe tregtimin e naftës së gazit dhe nënprodukteve të tyre” dhe Aktit nr.7 datë 18.03.2022 “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së vecantë të krijuar në treg”. Në lidhje me monitorimin e çmimeve të



karburanteve dhe të ushqimeve të vendosur nga Bordi i Transparencës nga ISHMT këtë periudhë janë realizuar **832 inspektime dhe monitorime**. Në zbatim të Aktit normativ Nr.5 datë 12.03.2022 janë vendosur **17 masa administrative gjobë**.



☞ Për monitorimin dhe inspektimin e tregut në lidhje me ndalimin e qeseve plastike që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në VKM nr.367, datë 20.5.2022 “Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit, apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme” dhe më pas si pjesë e Task-Forcës në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 190, datë 15.11.2022. Janë kryer në total **2354 monitorime dhe inspektime për qeset plastike**. Janë vendosur 4 masa administrative nga të cilat 1 gjobë, 3 masa ndalim tregtimi dhe si rezultat janë sekuestruar 187 kg qese plastike jokonform.

☞ Gjatë muajve Korrik e Gusht 2022 pati moskryerje të çështjeve të inspektimit për shkak të problemeve me sistemin e-inspektimi si rezultat i sulmeve kibernetike.

## 5.1 DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË PRODUKTEVE JOUSHQIMORE (DMP)

Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve joushqimore gjatë vitit 2022 ka kryer në total **2095 inspektime** nga të cilat 1921 të programuara dhe 174 të pa programuara. Në raport me totalin është realizuar 90 % e planit vjetor të inspektimeve për vitin 2022. Janë vendosur **282 masa administrative në total** nga të cilat 176 janë gjoba, 68 paralajmërime dhe 38 masa urgjente. Janë kontrolluar **11059 produkte** nga të cilat 848 kanë qënë jo në konformitet. Në fokus për vitin 2022 ka qënë inspektimi i ashensorëve, lodrave, detergjentëve, instrumentave matëse ligjërish të kontrolluara në përdorim, parapaketimet, produktet elektrike. Inspektimet kanë qënë të kombinuara duke përfshirë edhe kontrollin e zbatimit të Ligjit nr.9902/2011 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, specifikiisht për Nenet 7, 8, 9, 12, si dhe në zbatim të VKM për qeset plastike.

### 5.1.1 Inspektimi Metrologjik

Janë kryer **1042 inspektime** nga të cilat 979 të programuara dhe 63 të pa programuara mbi bazë ankese. Janë vendosur në total **40 masa administrative** me vendim gjobë.

#### Inspektime për parapaketim

Janë kryer **401 inspektime** të subjekteve që tregtojnë produkte të paketuara, të subjekteve prodhues dhe importues të parapaketimeve. Janë kontrolluar **2279 produkte** nga të cilat 14 produkte kanë qënë jo në konformitet. Janë marrë **9 (nëntë) masa administrative** me vendim gjobë.



Inspektime për instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, në përdorim

Janë kryer **635 inspektime** për instrumenta matës. Janë kontrolluar 2210 **instrumente matëse** ligjërish të kontrolluara në përdorim nga të cilat 29 kanë qenë jo në konformitet. Janë marrë **31 masa administrative** me vendim gjobë.

Inspektime për instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, që vendosen në treg

Janë kryer **6 inspektime** për instrumente matëse që vendosen në treg. Janë kontrolluar **6 instrumente matëse**. Nuk është vendosur masë administrative gjobë.

**5.1.2. Produkte elektrike**

Inspektimet e produkteve elektrike për vitin 2022 përfshijnë inspektimet për produkte që mbulohen nga një rregull teknik si: frigoriferë, makina larëse, kondicionerë, furra shtëpiake, aspiratorë, aparate marrëse televizive, si dhe produkte që nuk mbulohen nga një rregull teknik si: adaptorë, priza, spina shtëpiake, etj.

Për vitin 2022 janë kryer në total **321 inspektime** nga të cilat 317 kanë qenë të planifikuara dhe 4 janë kryer mbi bazë ankese. Numri i **produkteve të kontrolluara ka qenë 1148** nga të cilat 36 kanë rezultuar jo në konformitet për sa i përket mungesës së markimit CE, dhe 43 kanë rezultuar jo në konformitet sa i përket shoqërimit të produkteve me Deklaratat e Konformitetit. Bazuar në këto gjetje është marrë masë e ndalimit të tregtimit për 36 produkte (llamba, invertera, UPS, ndriçues dekorativë etj)

Janë vendosur **67 masa administrative** nga të cilat 48 janë gjoba, dhe 17 masa urgjente dhe 2 paralajmërimë.

**5.1.3. Produkte mekanike**

Në total janë kryer **356 inspektime** nga të cilat **292** kanë qenë të programuara dhe **64** inspektime jashtë programit. Janë vendosur **116 masa administrative** në total nga të cilat 60 paralajmërimë, 45 gjoba dhe 11 masa urgjente (ndalimi i përdorimit të ashensorit).

Inspektime për ashensorët

Gjatë vitit 2022, janë kryer **309 inspektime** dhe janë kontrolluar 735 produkte nga të cilat 381 jo në konformitet. Janë marrë në total **114 masa administrative** nga të cilat 44 gjoba, 59 paralajmërimë dhe 11 masa urgjente (ndalimi i përdorimit të ashensorit).

Për vitin 2022 **janë regjistruar** pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut **430 ashensorë**.

Inspektimi i PMP

Janë realizuar **11 inspektime** për PMP ku janë kontrolluar 40 produkte nga të cilat 5 kanë qenë jo në konformitet. Nuk është marrë asnjë **masë administrative**.

Inspektimi i makinerive

Janë kryer **36 inspektime** të subjekteve që vendosin në treg makineri, ku janë kontrolluar 112 produkte nga të cilat 10 jo në konformitet. Janë vendosur **2 masa administrative**, nga të cilat 1 paralajmërim dhe 1 gjobë.

#### 5.1.4 Qelq/këpucë/lodra & siguria e përgjithshme

Për vitin 2022 në fokus të inspektimeve të këtij sektori kanë qenë lodrat, detergjentët, mbrojtja e konsumatorit<sup>4</sup>, produktet tekstile. Në total janë kryer **376 inspektime** nga të cilat 333 të programuara dhe 43 jashtë programit të nxitura nga ankesat dhe aktivitetet monitoruese. Janë vendosur në total **59 masa administrative** nga të cilat 6 paralajmërim, 43 gjoba dhe 10 masa urgjente. Janë kontrolluar **4569 produkte** në total nga të cilat 330 kanë qënë jo në konformitet.

##### Inspektimet për sigurinë e lodrave

Gjatë vitit 2022 janë realizuar **53 inspektime** të operatorëve ekonomikë importues dhe shpërndarës të produkteve lodra<sup>5</sup>. Në total përgjatë vitit 2022 janë kontrolluar **574 produkte** lodra nga të cilat 53 kanë rezultuar jo në konformitet. Janë vendosur **15 masa administrative** nga të cilat 9 gjoba dhe 6 masa urgjente.

Përgjatë muajit Korrik janë bllokuar rreth 22 artikuj lodra ujore (rreth 2000 copë), të cilat kanë rezultuar pa markimet përkatëse apo janë identifikuar në sistemet e shpejtë të shkëmbimit të informacionit si të rrezikshme (Safety Gate Alert).



##### Inspektimet për mbrojtjen e konsumatorëve

Janë realizuar **155 inspektime** ku janë kontrolluar rreth **2669 produkte** për përmbushjen e detyrimit të informacionit në gjuhën shqipe, në përputhje me nenin 7, 8, 9, 12 të Ligjit Nr.9902 datë 17.04.2008, " Për mbrojtjen e konsumatoreve", i ndryshuar. Nga këto janë konstatuar 213 produkte jo në konformitet, dhe si rezultat janë vendosur **23 masa administrative** ku 6 prej tyre me paralajmërim dhe detyra për korrigjimin e shkeljeve dhe 15 me masë administrative gjobë, 2 masa urgjente.

<sup>4</sup>Në zbatim të Ligjit nr.9902 datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorit", i ndryshuar.

<sup>5</sup> Në zbatim të Ligjit Nr.10489 datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore" dhe VKM Nr. 262/2013 Për miratimin e rregullit teknik "Për sigurinë e lodrave".

Kategoritë e produkteve të përfshirë në këto inspektime ishin mallra të ndryshëm industrialë, detergjentë, veshje/tekstile por në fokus kanë qënë edhe mobilitetë të cilat japin një informacion të mangët dhe çorientues lidhur me informacionin e përgjithshëm dhe treguesin e çmimit i cili mungon apo jepet në monedhë të huaj. Produktet u kontrolluan për informacionin e nevojshëm në gjuhën shqipe që duhet t'u disponohet konsumatorëve referuar Ligjit Nr.9902 datë 17.04.2008, "Për mbrojtjen e konsumatoreve", i ndryshuar.

Nga ana e sektorit janë ndjekur 3 ankesa konsumatore të depozituara nga qytetarë, të cilat kanë patur për objekt: mospërputhshmërinë e produktit me përshkrimin e reklamuar nga subjekti tregtar apo deklarin e çmimit. Nga këto, një rast mobilitet, 1 këpucë, 1 produkt dekorativ. Të tre ankesat janë zgjidhur në favor të konsumatorëve duke dëmshpërblyer me vlerën e produktit të rënë dakort mes palëve.

Gjithashtu janë ndjekur informacionet e përcjella nga ana e Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorëve për subjekte që reklamojnë produktet në monedhën euro apo mbi deklarin e çmimeve të ulura në mënyrë çorientuese dhe jo të saktë, mbi bazën e së cilës janë iniciuar 18 inspektime dhe janë vendosur 2 masa administrative për shkelje të kërkesave ligjore.

#### Inspektimet për sigurinë e përgjithshme

Gjatë vitit 2022 janë kryer **16 inspektime** për sigurinë e përgjithshme. Janë kontrolluar gjithsej 109 produkte artikuj fëmijësh përfshirë karrocet, rrethoret, biberonat dhe takëmet e fëmijëve në përputhje me standardet referuese që mbulojnë sigurinë e tyre. Nga produktet e kontrolluara kanë rezultuar 7 produkte jo në konformitet. Në total janë vendosur **3 masa administrative**, nga të cilat 1 masë gjorbë dhe 2 masa urgjente.

Janë ndjekur 4 raste të përcjella nga AKU për materiale në kontakt me ushqimin të cilat janë hequr nga tregjet në Bashkimin Europian të njoftuara në sistemin e shpejtë të shkëmbimit të informacionit (RASFF), përkatësisht për : Pjata dhe gota melamine për shkak të nivelit të migrimit të disa kimikateve nga fibrat e bambusë (230 copë), lugë supe silikon për shkak të migrimit të aminave primare aromatike dhe tigan gatimi me material jongjitës (50 copë) për shkak të migrimit të Bisfenol F Diglicidil Eter, pjata plastike të sheshta të kuqe më risk të identifikuar të migrimit të ngjyruarit në acide acetik. Për këto raste u mor masa ndalimit të përhershëm ose të përkohshëm deri në një njoftim të dytë nga autoritetet përkatëse (AKU) si dhe kthimi i produktit/lajmërimi i konsumatorëve. Lajmërimi për produktet u realizua edhe nëpërmjet website-it zyrtar të ISHMT-së.

Janë informuar të gjitha bashkitë e vendit në formë shkresore për detyrimin e respektimit të kriterëve dhe kushteve teknike që duhet të zbatojnë operatorët ekonomik në lidhje me procedurat e standardizimit dhe harmonizimit të lodrave që vendosen në parqe apo këndeve të lojërave për fëmijë.

#### Inspektimet për detergjentë

Janë realizuar **70 inspektive** në fushën e detergjentëve, të subjekteve tregtare prodhuese dhe importuese, të cilët janë kontrolluar në respektim të legjislacionit në fuqi Nr.10216/2010 “Për Detergjentët” dhe aktet nënligjore në fuqi për etiketimin. Gjithsej janë kontrolluar **362 produkte** detergjentë për konsumatorë apo industrial, nga të cilat **17 kanë rezultuar jo në konformitet**. Janë vendosur **5 masa administrative** me gjobë, për mangësi në etiketim apo dokumentacionin që duhet të paraqesin.

Gjithashtu për një pjesë të këtyrë produkteve është realizuar për herë të parë edhe verifikimi i etiketimit dhe klasifikimi në përputhje me VKM Nr. 488, Datë 29.6.2016 “Për Klasifikimin, Etiketimin dhe ambalazhimin e Kimikateve (Deklaratat e parandalimit të rrezikut dhe piktogramat)”. Subjektet janë informuar për detyrimet ligjore që duhet të përmbushin në zbatim të Ligjit Nr.27/2016 “Për menaxhimin e Kimikateve” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

#### Inspektive për tekstile/këpucë

Gjatë vitit 2022 janë realizuar **57 inspektive** në subjekte importuese të produkteve të tekstit, metrazhe apo veshje. Në total përgjatë vitit 2022 janë kontrolluar **450 produkte** nga të cilat 38 kanë rezultuar jo konform VKM Nr. 1058/2015 “ Mbi emrat e fibrave tekstile dhe etiketimi e markimi përkatës i përbërjes së fibrave të produkteve tekstile”. Janë vendosur 12 masa administrative gjobë si dhe janë lënë detyrat për korrigjimin e shkeljes brenda afateve të përcaktuara.

Nga kontrollet e produkteve të **tekstit janë marrë 35 mostra të cilat i janë nënshtruar testimit pranë laboratorit** të tekstit të Universitetit Politeknik të Tiranës për identifikimin e përbërjes së fibrës në përputhje me deklarinimin në etiketimin e produktit. Nga rezultatet e analizave kanë rezultuar 10 produkte tekstile, etiketimi i përbërjes së të cilave nuk ka qënë në përputhje me përqindjen reale të identifikuar sipas test-raporteve.

#### Inspektive për veshjet e këmbës

Gjatë vitit 2022 janë realizuar **23 inspektive** të operatorëve ekonomikë importues të këpucëve. Janë kontrolluar **403 veshje të këmbës**, të cilat kanë rezultuar konform kriterëve për etiketimin sipas VKM Nr. 222, datë 28.3.2012 “Për miratimin e rregullave teknike për etiketimin e materialeve që përdoren në përbërësit kryesorë të veshjeve të këmbës, në shitje për konsumatorët”

### **5.1.5. Trajnime**

Gjatë vitit 2022 në fushën e mbikëqyrjes së tregut për produktet joushqimore janë kryer 11 trajnime për inspektorët si më poshtë:

1. Web-binar verifikimi i dokumentave teknike si pjesë e verifikimit të dokumentave që mbulojnë pjesën e eco-design dhe etiketimin e efencës së energjisë. 20 janar 2022
2. Trajnim datë 15-17 Mars 2022, mbi legjislacionin e kimikateve per inspektorët në kuadrin e projektit “Përmirësimi i menaxhimit të kimikateve në Shqipëri”, organizuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim;

3. Trajnim datë 28 Prill 2022 mbi kërkesat e akteve europiane mbi Pajisjet nën presion dhe Enët e thjeshta nën presion (respekvisht Directive 2014/68/EU on pressure equipment (PED) dhe Directive 2014/29 on simple pressure vessels (SPVD), organizuar me mbështetjen e Projekt SANECA/GIZ, në bashkëpunim me ASPA dhe College of Europe;
4. Trajnimit datë 4-5 Maj 2022 mbi NAWI, MID si dhe mbi Shishet enëmatëse dhe Parapaketimet organizuar me mbështetjen e Projekt SANECA/GIZ, në bashkëpunim me ASPA dhe College of Europe;
5. Trajnimi datë 11 Maj mbi LVD, PPE, Toys, organizuar me mbështetjen e Projekt SANECA/GIZ, në bashkëpunim me ASPA dhe College of Europe;
6. Trajnimi datë 18 Maj 2022 mbi kërkesat e Direktivës 2014/33/EU mbi ashensorët dhe komponentët e sigurisë për ashensorë, harmonizimin dhe zbatimin në praktikë të tyre, si edhe kërkesat për ashensorët në përdorim , organizuar me mbështetjen e Projekt SANECA/GIZ, në bashkëpunim me ASPA dhe College of Europe;
7. Trajnim mbi legjislacionin e kimikateve për inspektorët me fokus të veçantë në vlerësimin e rreziqeve të substancave dhe përzierjeve kimike, deklaratat e parandalimit të rrezikut, kujdesit që janë të domosdoshme për tu zbatuar nga prodhuesit e kimikateve dhe përzierjeve kimike. 31 Maj- 2 Qershor ;
8. Trajnimi mbi kërkesat e Direktivës 2006/42/EU për makineritë në lidhje me kapitullin 1 PKIE “Lëvizja e lirë e mallrave”, organizuar me mbështetjen e Projekt SANECA/GIZ, në bashkëpunim me ASPA dhe College of Europe, 1 Qershor 2022;
9. Trajnimi mbi kërkesat e Rregullores (EU) 2016/426 mbi pajisjet e gazit dhe Direktivës 75/324/EEC mbi pajisjet e aerosolit, organizuar me mbështetjen e Projekt SANECA/GIZ, në bashkëpunim me ASPA dhe College of Europe, 15 Qershor 2022;
10. Trajnimi mbi kërkesat e Rregullores 305/2011/EU mbi produktet e ndërtimit, harmonizimi i së cilës është planifikuar edhe në PKIE 2022 – 2024, organizuar me mbështetjen e Projekt SANECA/GIZ, në bashkëpunim me ASPA dhe College of Europe, 23 Qershor 2022;



11. Trajnim për fuqizim të kapaciteteve lidhur me garancinë ligjore dhe tregtare të konsumatorëve. Inspektorët e ISHMT-së u trajnuan nga ekspertja e fushës, Nada Dollani, për zbatimin e kriterëve të përcaktuara në ligjin “Për mbrojtjen e konsumatorit” me fokus të veçantë

garancinë ligjore dhe tregtare. Pjesë e trajnimit ishin edhe përfaqësues të subjekteve tregtare dhe të shoqatës “Bashkimi tregtar i Shqipërisë”, dhe Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve, datë 30 Shtator 2022;

## 5.2 DREJTORIA E PRONËSISË INTELEKTUALE

Gjatë vitit 2022 nga Drejtoria e Pronësisë Intelektuale janë kryer në total **457 inspektime** nga të cilat 401 kanë qenë inspektime të programuara dhe 56 inspektime të pa programuara, mbi bazë ankese dhe nga monitorimet e realizuara. Janë vendosur **73 masa administrative**, nga të cilat 6 paralajmërim, 65 gjoba dhe 2 bllokime të përhershme të produktit.

### 5.2.1 Inspektimi mbi të drejtën e autorit

Janë kryer në total **350 inspektime**, nga të cilat 333 kanë qenë të programuara dhe 17 të nxitur nga ankesat dhe nga monitorimet e realizuara. Janë vendosur **44 masa administrative** (6 paralajmërim dhe 38 gjoba).

#### Inspektimi OSHMA (Radio+Kabllor)

Janë kryer **50 inspektime**. Janë marrë 11 masa administrative nga të cilat 6 gjoba dhe 5 paralajmërim.

#### Inspektimi i programeve kompjuterike

Janë kryer **173 inspektime** mbi subjektet përdorues të programeve kompjuterike. Janë marrë 15 masa administrative (1 paralajmërim dhe 14 gjoba).

#### Inspektimi i Shtëpive Botuese/librari/fotokopje

Janë kryer **65 inspektime** mbi kategoritë e përdoruesve të veprave letrare. Nuk janë marrë masa administrative.

#### Inspektime të veprave audio-vizuale

Janë kryer **56 inspektime** të veprave audio-vizuale. Janë marrë 14 masa administrative (14 gjoba).

#### Inspektime Ankesa dhe Pirateri Online

Janë kryer **6 inspektime**. Janë marrë 6 masa administrative (6 gjoba).

### 5.2.2 Inspektime mbi pronësinë industriale

Gjatë vitit 2022 janë kryer në total **107 inspektime**. 39 Inspektime janë kryer në bazë kërkesë ankese dhe 68 inspektime ex-officio.

Nga këto inspektime janë vendosur në total **27 masa administrative** me gjobë dhe 2 vendime për bllokim të përhershëm dhe shkatërrim të mallrave të fallsifikuara.

### 5.2.3. Trajnime

1. Workshop mbi zbatimin e pronësisë intelektuale në tregun e brendshëm. Organizuar në kuadrin e Projektit TAIEX në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë/Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Shqipëri, në të cilin morën pjesë 24 punonjës të ISHMT si dhe pjesëmarrës nga DPPI, DDA, AMA, DPD, DPP, 14 Shtator 2022;

2. Trajnimi "Twinning projects as a tool to deliver support to the Public Administrations", 23 Shtator 2022;
3. Trajnim për fuqizim të kapaciteteve lidhur me garancinë ligjore dhe tregtare të konsumatorëve. Inspektorët e ISHMT-së u trajnuan nga ekspertja e fushës, Nada Dollani, për zbatimin e



kritereve të përcaktuara në ligjin “Për mbrojtjen e konsumatorit” me fokus të veçantë garancinë ligjore dhe tregtare. Pjesë e trajnimit ishin edhe përfaqësues të subjekteve tregtare dhe të shoqatës “Bashkimi tregtar i Shqipërisë”, dhe Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve, datë 30 Shtator 2022;

4. Trajnim “Mbi rregullat e BE - së në fushën e ligjit dhe politikës së pronësisë intelektuale dhe mbi rregulloret e aplikuara për inspektimet në tregun e brendshëm”.
5. Workshop SHIEL III, organizuar nga EUROPOL I në bashkëpunim me Zyrën e Pronësisë Intelektuale të Bashkimit Evropian (EUIPO), dhe Policinë e Shtetit mbi falsifikimin e produkteve mjekësore, datë 20 Dhjetor 2022.

### 5.3 DREJTORIA TEKNIKE (DT)

#### Përshkrim i shkurtër

Drejtorja Teknike me strukturën e re të miratuar ka një rritje të stafit me 2 punonjës (1+6). Numri i punonjësve të DT në fund të vitit 2022 ishte 6.

Fusha e veprimtarisë së kësaj drejtorie është:

- ✓ Kontribuimi në përgatitjen dhe zhvillimin e politikave të mbikëqyrjes së tregut;
- ✓ Ndjekja e përditësimit me direktivat përkatëse të BE-së/rregulloreve të transpozura për mbikëqyrjen e tregut;
- ✓ Koordinimi i mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të informacioneve mbledhur nga dy drejtoritë e tjera;
- ✓ Analiza e raporteve periodike të dorëzuar nga çdo sektor në lidhje me punën e kryer në terren (inspektime), problematikën e hasur dhe sugjerimet për përmirësimin në vazhdimësi;
- ✓ Përpunimi i statistikave të mbledhura mbi inspektimet e kryera gjatë kësaj periudhe kalendarike në raport me Indikatorët e Performancës;
- ✓ Zhvillimi, koordinimi dhe bashkërendimi i politikave në fushat që mbulon ISHMT, si dhe kur është e nevojshme, bashkëpunon me drejtori të tjera të ISHMT-së dhe me institucine të tjera shtetërore, private, aktorë ndërkombëtarë;
- ✓ Raportimi i brendshëm e i jashtëm i ISHMT-së.

#### 5.3.1 Raporte të hartuara

Kjo drejtori ka gjeneruar raporte periodike të brendshme dhe për institucione e organizma të tjera sipas kërkesave të vazhdueshme drejtuar ISHMT-së. Raportet e hartuara nga kjo drejtori janë:

- ✓ Raportimet periodike të ISHMT-së (javore, mujore, 6-mujore dhe vjetore);
- ✓ Raportimet për Planin Kombëtar Për Integrimin Evropian (PKIE) 2017 – 2020 dhe Strategjinë Kombëtare për Zvillim dhe Integrim (SKZHI) (kapitullin 1, kapitullin 7 dhe kapitulli 28 );
- ✓ Raportimet për Strategjinë Ndër-sektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2020;
- ✓ Raportimet për Kontratën e Performancës me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë;
- ✓ Raportin për Inspektoratin Qendror (IQ) mbi inspektimet e realizuara në bazë të një liste indikatorësh të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm.
- ✓ Raporte monitoruese mbi punën e kryer nga ISHMT.
- ✓ Përgjitje informacionesh për CEFTA, SME, etj.

### **5.3.2 Mbështetje në zbatimin dhe hartimin e metodologjive të lidhura me procesin e inspektimit**

DT ka mbështetur punën për hartimin e listë-verifikimeve dhe dokumentave standarde për produkte që përfshihen në fokusin e punës së DMP.

DT ka kontribuar në hartimin e :

- Metodologjisë së analizës së riskut;
- Udhëzimit të bllokimit të produkteve që nuk janë në konformitet;
- Marrëveshjes së Bashkëpunimit me ISHTI-n;
- Marrëveshjes së Bashkëpunimit me DPD;
- Rregullores se përditësuar të ISHMT-së;

Ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me IQ në lidhje me zbatimin e sistemit të inspektimit on-line, E-inspection, mbi problematikat e ndeshura, eliminimin e tyre, etj.

DT ka mbledhur të dhëna statistikore nga çdo sektor/drejtori në lidhje me inspektimet të cilat hidhen rregullisht në një database, përpunohen dhe prezantohen në raporte të ndryshme si dhe shërbejnë si bazë për monitorimin e punës së ISHMT-së duke evidentuar problematikat dhe përcaktuar mënyrat për minimizimin/ose eliminimin e tyre.

### **5.3.3 Mbështetje për plotësimin , përmirësimin dhe përditësimin e legjislacionit sektorial të fushë veprimtarisë së ISHMT-së**

DT ka dhënë mendim dhe komente në lidhje me draft VKM : për qeset plastike, pajisjet aerosol, enët e thjeshta në presion, aeroplanët pa pilot, të akteve normative në lidhje me monitorimin e çmimeve të karburanteve dhe të ushqimeve të vendosur nga Bordi i Transparencës, për masat lidhur me sigurimin e informacionit mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO<sub>2</sub> gjatë marketingut të automjeteve të reja, etj.



## 5.4. DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse ka 2 sektorë, Sektori Juridik dhe Shërbimeve Mbështetëse 1+7 ( aktualisht 7 punonjës) dhe Sektori Financës 1+2 (aktualisht 2 punonjës).

### 5.4.1 Ndjekja e ankimeve administrative të gjobave të vendosura nga strukturat e ISHMT

Gjatë vitit 2022, në Sektorin Juridik dhe Shërbimeve Mbështetëse rezultojnë gjithsej 258 masa administrative gjobë.

Pranë ISHMT-së janë paraqitur 158 ankime administrative, nga të cilat 33 masa janë rrëzuar me vendim të Komisionit të Ankimit (KA), të cilat janë marrë në shqyrtim në mbledhjet e zhvilluara nga ky Komision.

Gjatë vitit kalendarik 2022 janë zhvilluar gjithsej 12 mbledhje të Komisionit të Ankimit.

Në respektim të procedurave të parashikuara në Urdhrin nr. 52, datë 16.07.2018“Për miratimin e procedurave të hollësishme të shqyrtimit të ankimit administrativ nga Komisioni i Ankimit pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”, janë ndjekur të gjitha procedurat e njoftimit të subjekteve për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të Komisioneve të Ankimit.

### 5.4.2 Përfaqësimi i ISHMT-së në procese gjyqësore

Gjatë vitit 2022 janë ndjekur në Gjykatë 56 çështje gjyqësore nga të cilat:

- 15 prej tyre janë rrëzuar kërkesëpaditë e subjekteve ankimuese;
- 17 prej tyre janë pranuar kërkesëpaditë kundër ISHMT-së;
- 22 çështje janë në proces në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
- 2 prej tyre janë pranuar pjesërisht.

Ndërsa 9 çështje janë në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit nga të cilat për 8 prej tyre është bërë ankim nga ana e ISHMT-së, për 1 (një) çështje do të bëhet ankim pasi të komunikohet vendimi i arsyetuar i gjykatës në respektim të afateve procedurale. Dhe së fundmi përditësohet se 4 çështje janë fituar në këtë gjykatë.

### 5.4.3. Buxheti & Financa

Për sa i përket **buxhetit të miratuar për ISHMT** nga fondi i planifikuar prej 113.669.952.lekë janë shpenzuar 95.551.706 lekë , dmth 92 % e buxhetit total është përdorur, sipas tabelës si mëposhtë:

#### Tabela 3: Buxheti i alokuar dhe shpenzuar për vitin 2022

Zërat	Emërtimi	Fondet e çelura	Fondet e shpenzuara	Realizimi (%)
600	Paga	67,500,000	64,177,000	95%
601	Sigurime Shoqërore e	14,000,000	10,806,707	77%
602	Shpenzime korentë	21,394,060	19,792,107	93%
231	Investime	775,892	775,892	100%
<b>TOTALI</b>		<b>103,669,952</b>	<b>95,551,706</b>	<b>92%</b>

Për pagat e punonjësve të ISHMT janë paguar 64.177.000 lekë ose 95% e totalit të pagave të çelura në fillim të vitit buxhetor 2022 në shumën 67.500.000lekë.

Për Sigurimet Shoqërore Shëndetësore dhe Tatimet për pagat e marra nga punonjësit e ISHMT janë paguar 10.806.707lekë ose 77 % e totalit të vitit buxhetor 2022 në shumën 14.000.000 lekë të sigurimeve të çelura në fillim të vitit 2022 .

Për zërin e Investimeve janë përdorur 775 892 lekë ose 100% e totalit të vitit buxhetor 2022 në shumën 775 892 lekë të çelura në fillim të vitit 2022 .

Nga planifikimi i zërit të investimeve për vitin 2022 janë realizuar investimet e mëposhtme:

- Blerje të pajisjeve dhe instrumentave për testim dhe inspektim në terren në vlerën 10 292 lekë me Tvsh.
- Blerje pajisje kompjuterike (kompjuterat dhe laptop) në vlerën 765.600 lekë me Tvsh.

Për vitin 2022 janë arkëtuar të ardhura në buxhet **16 615 170** lekë të ndara si më poshtë:

- Arkëtim nga gjobat e inspektimeve në vlerë 15 140 015 lekë
- Arketim nga sekuestrime dhe zhdëmtime në vlerë 43 435 lekë
- Arketim nga auditimi (KLSH) në vlerë 1 374 120 lekë
- Të ardhura nga kthim në buxhet për kryerje analiza në vlerë 57 600 lekë.

#### 5.4.4 Burimet njerëzore

ISHMT ka në organikë 80 punonjës, nga të cilët 66 janë të emëruar dhe 14 pozicione janë vakante. Numri i punonjësve sipas sektorëve dhe drejtorive përkatëse është si në tabelën më poshtë.

**Tabela 4: Staf i ISHMT sipas sektorëve dhe drejtorive, Dhjetor 2022**

Drejtorite/Sektorët	Numri i punonjësve sipas strukturës së miratuar	Numri aktual i punonjësve	%
<b>DREJTORIA TEKNIKE</b>	<b>7</b>	<b>6</b>	<b>86%</b>
<b>DREJTORIA E MBIQEQRJES SE PRODUKTEVE</b>	<b>42</b>	<b>36</b>	<b>86%</b>

Sektori I Produkteve Elektrike	7	4	57%
Sektori I Produkteve Mekanike	9	9	100%
Sektori I Metrologjisë	16	15	94%
Sektori Kimik dhe Siguria e Përgjithshme	9	7	78%
<b>DREJTORIA E PRONESISE INTELEKTUALE</b>	<b>18</b>	<b>14</b>	<b>78%</b>
Sektori I Pronësisë Industriale	7	5	71%
Sektori I të Drejtave të Autorit	10	8	80%
<b>DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE</b>	<b>12</b>	<b>9</b>	<b>75%</b>
Sektori juridik dhe shërbimeve mbështetëse	8	6	75%
Sektori I Financës	3	2	67%
	<b>80</b>	<b>66</b>	<b>83%</b>

### Disiplina në punë

Gjatë vitit 2022 është verifikuar listëprezenca e nëpunësve rregullisht dhe sistemi i hyrje-daljeve në ISHMT. Është monitoruar zbatimi i Kodit të Etikës së ISHMT-së. Janë kryer vlerësimet e punës për periudhat korrik-dhjetor 2021 dhe janar-qershor 2022.

### Performanca sipas kriterëve

Bazuar në ndryshimet në strukturën e ISHMT-së sipas Urdhërit nr.73, datë 01.06.2020, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut , VKM nr.172, datë 18.03.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.36 datë 20.01.2016 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”, dhe rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit në lidhje me procesin e inspektimit , shkresa Nr. 975/16 Prot., datë 04.11.2021, është hartuar Rregullorja e re e ISHMT-së dhe është dërguar për miratim në MFE.

### Masa disiplinore të marra

Për vitin 2022 janë ngritur 7 komisione disiplinore dhe është marrë 1(një) masë disiplinore “largim nga shërbimi civil”, 3 masa disiplinore “mbajtja e 1/8 së pagës për një periudhë 3 muaj, 2 masa vërejtje.

### Ngritje në detyrë, lëvizje paralele

Gjatë vitit 2022 janë kryer: 2 ngritje në detyrë; 7 pranime nga jashtë shërbimit civil; 2 transferime të përhershme; 2 lëvizje paralele; 7 emërimë punonjës më kontratë të përkohshme 6 orë/ditë dhe 7 emërimë punonjës më kontratë të përkohshme 8 orë/ditë (specialist).

### **5.4.5 Trajnime**

Gjatë vitit 2022 stafi i kësaj drejtorie ka marrë pjesë në **6 trajnime** të organizuar nga ASPA në lidhje me procedurat administrative, prokurimin publik, burimet njerëzore, buxhetin afatmesëm, të drejtën e informimit, etj.

## VI. PUBLIKIME & AKTIVITETE SENSIBILIZUESE



### 6.1 Publikime

Me mbështetjen e GIZ dhe të projektit ALSIP të zyrës Zviceriane të Pronësisë Intelektuale janë printuar broshura informuese mbi parapaketimet, LVD, shishet enëmatëse, të drejtat e pronësisë intelektuale, etj.

**Është përditësuar** në mënyrë të vazhdueshme **informacioni në web-site** e ISHMT-së [www.ishmt.gov.al](http://www.ishmt.gov.al) .

**Përditësimi i rrjeteve sociale** mbi aktivitetet mbikëqyrëse të kryera nga ISHMT në bazë javore, si dhe publikimi i informacioneve të dobishme për konsumatorët apo operatorët ekonomikë.

### 6.2 Aktivitete sensibilizuese

**Në total nga ISHMT gjatë vitit 2022 janë realizuar 20 takime për informimin e operatorëve ekonomikë dhe konsumatorëve, printim dhe shpërndarje e fletëpalosjeve informuese në lidhje me fushë veprimtarinë e ISHMT-së.**

Për ndërgjegjësimin e konsumatorëve dhe të operatorëve ekonomikë **për sigurinë e produkteve joushqimore** janë realizuar aktivitetet si më poshtë:

- Pjesëmarrja në konferencën “Rëndësia e Infrastrukturës së Cilësisë dhe Pronësisë Industriale në Tregun e Brendshëm dhe Ndërkombëtar” orgnizuar nga MFE, datë 22 Shkurt 2022;
- Takim informues në datën 17.03.2022 me operatorë ekonomik në lidhje me kriteret ligjore që duhet të plotësojnë në zbatim të VKM Nr.443, datë 22.07.2021 “Për miratimin e rregullores për parapaketimet” dhe VKM Nr. 349, datë 16.6.2021 “Për miramin e rregullores për shishet enëmatëse” me mbështetjen e MFE dhe Projektur të GIZ "Support for the Implementation of the EU-compliant Albanian Legislation" .
- Takim Informues dhe diskutimi mbi Rregulloren Teknike mbi pajisjet për përdorim brenda disa kufijve të tensionit (LVD) , miratuar me VKM 349/2020, 27 prill 2022.
- Në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, ISHMT organizoi një aktivitet sensibilizues pranë Liqenit Artificial të Tiranës mbi rëndësinë e kujdesit në përzgjedhjen e produkteve të sigurta për jetën dhe shëndetin e fëmijëve. Stafi i ISHMT në bashkëpunim edhe me Agjencinë e Mbrojtjes Konsumatore shpërndanë fletëpalosje broshura informuese mbi artikujt si lodra, biçikleta, artikuj të kujdesit ndaj tyre (takëme dhe tavolinat e ngrenies, karroca, rrethore,

krevate, biberona etj). Prindërit dhe familjarët u këshilluan mbi elementët e sigurisë si markimi CE, fiksimin e standardit për artikujt e kujdesit, paralajmërimet e moshës, instruksionet e përdorimit dhe të mirëmbajtjes, të cilat duhen kontrolluar përpara blerjes për fëmijët e tyre.

- Takimi me përfaqësues të Organeve të Miratuara mbi sigurinë e ashensorëve i organizuar nga ISHMT, 9 Shtator 2022.
- Dalje në media në emisionin dedikuar konsumatorëve “ALERT”, me tematikë “Çfarë nuk duhet të blejmë për festa”. Në këtë emision u diskutua mbi produktet joushqimore si lodra, produkte elektrike të cilat bëhen më prezente në treg përgjatë periudhës së festave të fundvitit, mënyrën se si konsumatorët të sigurohen për blerjet e tyre, format e adresimit të ankesave pranë ISHMT, 23 Dhjetor 2022



Për ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë **për të drejtat e pronësisë intelektuale** janë realizuar aktivitetet si më poshtë:

- Takim më 9 Mars 2022, me përfaqësues të Drejtorisë së të Drejtave të Autorit, SIT, One-Stop-Shop për Menaxhimin e të Drejtave të Autorit dhe përfaqësues të “Hotel Associations”. Takimi u organizua me mbështetjen e projektit ALSIP dhe u fokusua në rolin e të drejtave të autorit dhe mbrojtjen e tyre, duke përfshirë metodologjinë e tarifimit. ISHMT prezantoi mbi rolin dhe funksionin e institucionit; Leksione të hapura u organizuan në Universitetin Epoka, Instituti i Studimeve Evropiane, Universiteti Evropian i Tiranës, Universiteti Luarasi, Fakulteti i Drejtësisë në Universitetin e Tiranës. ISHMT prezantoi para studentëve funksionet dhe rolin e tij për mbrojtjen e IP;
- ISHMT mori pjesë në takimin “Tryezë e rrumbullakët me institucionet e IP” organizuar nga DPPI, datë 19 Prill 2022;
- Takime me 70 biznese në qendrat tregtare të Tiranës për këshillim mbi kriteret ligjore në lidhje me respektimin e të drejtave të PI, datë 21 Prill 2022;
- Pjesëmarrja në Konferencën Kombëtare të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale 26 Prill 2022;
- Ndërgjegjësimi i konsumatorëve dhe mbajtësve të të drejtave mbi respektimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale, nëpërmjet standave të ngritura në qytetin e Tiranës, ku u shpërndanë fletëpalosje;
- Publikimi i disa artikujve dhe informacioneve me temë mbi zbatimin e të drejtave të PI, në faqen e internetit të ISHMT dhe mediat sociale.



- Trajnim i Përfaqësuesve të autorizuar të Pronarëve të objekteve të Pronësisë Industriale, mbi zbatimin e të drejtave të Pronësisë Industriale në rrugë administrative, kompetencat e ISHMT, datë 28 Qershor 2022.
- Workshop me biznesin në qytetin e Durrësit, ku u prezantua roli i ISHMT-së për mbrojtjen e të drejtave të PI. Workshopi u realizua në bashkëpunim me DPPI dhe DDA në kuadrin e projektit të DPPI mbi identifikimin e markave tregtare, datë 2 Nëntor 2022;
- Workshop me biznesin në qytetin e Pogradecit, ku u prezantua roli i ISHMT-së për mbrojtjen e të drejtave të PI. Workshopi u realizua në bashkëpunim me DPPI dhe DDA në kuadrin e projektit të DPPI mbi identifikimin e markave tregtare, datë 7 Nëntor 2022;
- Workshop me biznesin në qytetin e Elbasanit, ku u prezantua roli i ISHMT-së për mbrojtjen e të drejtave të PI. Workshopi u realizua në bashkëpunim me DPPI dhe DDA në kuadrin e projektit të DPPI mbi identifikimin e markave tregtare, datë 10 Nëntor 2022;
- Takim me biznesin dhe Dhomën e Tregtisë të Qytetit të Vlorës në kuadër të projektit “Identifikimi i markave tregtare dhe Disenjove Industriale”, të zhvilluar nga DPPI ku u prezantua zbatimi i të drejtave të PI dhe funksionet e ISHMT-së, datë 7 Dhjetor 2022;
- Dërgim informacioni në rrugë elektronike tek 39 subjekte tregtare shqiptare që kanë regjistruar marka pranë DPPI, me qëllim ndërgjegjësimin dhe njohjen e funksioneve të ISHMT për zbatimin e Pronësisë Intelektuale, datë 15 Dhjetor 2022.
- Workshop "Pronësia Intelektuale dhe Inovacioni për Universitetet dhe SME-të" në qytetin e Durrësit me pjesëmarrës studentë dhe biznese. ISHMT prezantoi masat administrative ndaj cënimit të të drejtave të PI dhe rolin e ISHMT. Aktiviteti u realizua në bashkëpunim me DPPI dhe DDA, datë 17 Dhjetor 2022

## VII. PROBLEMATIKA TË HASURA

ISHMT është përballur më këto problematika të listuara si më poshtë:

- Mungesa e logjistikës konkretisht me automjete të transportit për trupat inspektuese në kryerjen e detyrave funksionale të institucionit, të cilat sjellin vështirësi në realizimin e planit të inspektimeve, duke pasur në konsideratë shtrirjen e gjerë territoriale (i gjithë territori i vendit) të ushtrimit të funksionit të ISHMT-së. Automjetet në pronësi të ISHMT-së të cilat janë në dispozicion të trupave inspektuese janë marrë me kalim kapitali nga DPM dhe MFE, janë të amortizuara dhe kanë shfaqur probleme gjatë kryerjes së punës. ISHMT ka arritur për vitin 2022, të realizojë një numër të lartë inspektimesh e kontrollesh duke mos u kufizuar vetëm në zbatimin e legjisllacioneve të tij integrale, por edhe për zbatimin e akteve të tjera ligjore/nënligjore si Aktet normative për respektimin e çmimeve tavan të vendosura nga Bordi i Transparencës për karburantet apo ushqimet, si dhe zbatimin e VKM Nr.367/2022 “ Për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit importimit të qeseve plastike mbajtëse “ me trashësi <70 mikron, me përmasa më të vogla se 24 cm gjerësi dhe 50 cm gjatësi. Këto kontrolle janë realizuar duke përdorur mjetet e transportit publik në pjesën thelbësore të tyre.

- Mangësi në vlerësimin e sigurisë së produkteve nëpërmjet aparaturave dhe pajisjeve e cila lidhet jo vetëm me numrin shumë të kufizuar të këtyre pajisjeve dhe aparaturave, por edhe me mungesën e trajnimeve më të avancuara për përdorimin e tyre.
- Mungesa e një procedure për produktet që duhet t'i nënshtrohen analizave laboratorike në laboratorë të huaj, duke patur në konsideratë që në Shqipëri ekziston vetëm një laborator i akredituar për analizat e tekstilit dhe lëkurës, ndërsa për produkte të tjera që janë në fokusin e inspektimit të ISHMT-së si: lodra, detergjentë, produkte të kujdesit për fëmijë, etj., analizat duhet të kryhen në laboratore të akredituar të huaj. Kërkohej një procedurë lehtësuese prokurimi në mënyrë që përgjigjet e testimeve të produkteve joushimore nga laboratorët e akredituar të mos i tejkalojnë afatet ligjore për marrjen e vendimit përfundimtar të inspektimit.
- Buxheti i limituar i vënë në dispozicion për këtë inspektorat duke pasur në konsideratë gamën e gjerë të produkteve që mbulon për inspektim si dhe mbulimin e gjerë territorial të vendit. Gjithashtu mungesa e fondeve buxhetore për vitin 2022 për trajtimin e punonjësve që udhëtojnë larg qëndrës së punës, ka sjellë vështirësi në kryerjen e inspektimeve nëpër rrethe.
- Mungesa e buxhetit për aktivitete sensibilizuese, fletpalosje, trajnime, etj.
- Mungesa e përditësimit të adresave të subjekteve në QKB, e cila sjell që shumë inspektime të mos kryhen sepse subjektet nuk gjenden nga inspektorët në adresat që ata kanë deklaruar në QKB. Kontaktet janë të paarritshme dhe shumë subjekte që rezultojnë në databaza të institucioneve si DPD dhe DPT si aktive, pra si importues apo tatimpagues aktiv, në terren nuk evidentohen sipas adresave të deklaruara. Gjithashtu deklarimi i objektit të veprimtarisë së subjekteve në mënyrë fiktive në QKB është një problematikë e hasur. Këto problematika kanë ndikuar ndjeshëm në realizimin e planeve mujore të inspektimit. Konkretisht janë **1001 inspektime të porealizuara** për arsyt si më lart përmendur.

## VIII. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Rekomandimet janë ngushtësisht të lidhura me sfidat e ndeshura gjatë vitit 2022. Ndaj si rekomandime kryesore mund të përmendim:

- ✓ Inicimi dhe kontribuimi në hartimin e një procedure për kryerjen e analizave laboratorike në laboratorë të huaj të akredituar për produkte për të cilat nuk ka laboratorë të tillë në Shqipëri.
- ✓ Fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstytucional që do t'i shërbejë punës dhe ndërmarrjen e veprimeve dhe aksioneve në mbrojtjen e konsumatorit, si dhe në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të sigurta dhe cilësore.

- ✓ Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore të ISHMT-së nëpërmjet trajnimeve, seminareve, workshopeve, vizitave studimore, duke synuar rritjen e shkallës së profesionalizmit dhe implementimin e metodave bashkëkohore në fushën e inspektimit, veçanërisht për sigurinë e produkteve joushqimore.
- ✓ Rritja e aksesit të subjekteve ndaj informacionit për detyrimet që duhet të plotësojnë në zbatim të legjislacionit ekzistues sipas fushave specifike që janë në fokusin e ISHMT-së.
- ✓ Rritja e aksesit të konsumatorit ndaj informacionit mbi sigurinë e produkteve joushqimore duke e bërë pjesëmarrës në rritjen e cilësisë së shërbimeve.
- ✓ Fuqizimi i bashkëpunimit me strukturat homologe të vendeve të Rajonit në fushën e mbikëqyrjes së tregut dhe të respektimit të të drejtave të pronësisë intelektuale.

## IX. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2023

Për vitin 2023 prioritetet e punës së ISHMT-së do të jenë:

### **Kontrolli i respektimit të kriterëve ligjore (Inspektimet)**

Fokusi kryesor do të jetë në: A) grup-produktet që kanë rezultuar me problematika të ndryshme në vitet paraardhëse, që kanë një ndjeshmëri në treg si p.sh instrumentat matës ligjërisht të kontrolluar, parapaketimi, dekodera, karikues, llamba, etj, regjistrimi i ashensorëve në ISHMT, produkte për të cilat deri tani, nuk ka patur veprimtari mbikëqyrëse si: kimikate, artikujt aerosol, enët e thjeshta nën presion, pajisjet e gazit, artikujt piroteknik, etj.; B) respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Në vitin 2023 do të realizohen në total **2580 inspektime nga të cilat 2064 të programuara dhe 516 të pa programuara.**

1536 inspektime të programuara dhe 384 të pa programuara në fushën e mbikëqyrjes së tregut të produkteve joushqimore dhe 528 inspektime të programuara dhe 132 të pa programuara në fushën e pronësisë intelektuale.

Nr.	ISHMT	Numër inspektimesh total	Nr inspektimesh të programuara
<b>1</b>	<b>Drejtoria e Produkteve Joushqimore</b>	<b>1920</b>	<b>1536</b>
1.1	Sektori i Produkteve mekanike	480	384
1.2	Sektori i Produkteve Elektrike	240	192
1.3	Sektori Kimik dhe Siguria e Përgjithshme	360	288



1.4	Spektori i Inspektimit Metrologjik	840	672
<b>2</b>	<b>Drejtoria e Pronësisë Intelektuale dhe Industriale</b>	<b>660</b>	<b>528</b>
2.1	Sektor i Pronësisë Industriale	<b>180</b>	<b>144</b>
2.2	Spektori i të Drejtës së Autorit	<b>480</b>	<b>384</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>2580</b>	<b>2064</b>

### **Informimi**

- Informimi i operatorëve ekonomikë për zbatimin e kriterëve ligjorë mbi sigurinë e produkteve joushqimore si dhe mbi respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.
- Informimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve mbi sigurinë e produkteve dhe mbi të drejtat e tyre si konsumator.

### **Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore**

Trajnime të vazhdueshme të stafit për rritjen e shkallës së njohurive në fushat përkatëse.

### **Bashkëpunimet ndërinstitucional dhe Rajonal**

- Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e mbikëqyrjes së tregut dhe të pronësisë intelektuale.
- Fuqizimi i bashkëpunimit të ISHMT-së me Autoritetet e Mbikëqyrjes së Tregut të vendeve të Rajonit për shkëmbim eksperience dhe të përvojave më të mira.

## X. ANEKS

Tabela 1: Indikatorët mbi procesin e inspektimit

Nr.	Treguesit e vlerësimit të veprimtarisë inspektuese	Përqindja (%) e peshës specifike për çdo tregues			Kritere të vlerësimit të treguesit	Vlerësimi 1	Vlerësimi 2	Vlerësimi 3	Vlerësimi 4
1	Inspektime të programuara	15	90.4	13.56	numri i inspektimeve të kryera brenda programit (numri i inspektimeve të kryera jashtë programit)/numri i inspektimeve të kryera gjithsej	≤ 20%	20-50%	50-80%	80-100%
2	Inspektime të autorizuara	9	90.4	8.13	numri i autorizimeve me programim (numri i autorizimeve jashtë programit)/numri i autorizimeve të gjeneruara	≤ 20%	20-50%	50-80%	80-100%
3	Njoftimi i inspektimeve	9	14.9	1.34	numri i inspektimeve të njoftuara (numri i inspektimeve të panjoftuara)/numri i inspektimeve të kryera gjithsej	≤ 20%	20-50%	50-80%	80-100%
4	Kohëzgjatja e inspektimit	7	0.4	0.03	numri i inspektimeve për të cilat është kërkuar shtyrje e kohëzgjatjes së tyre apo atyre që kalojnë kohën maksimale të inspektimit në subjekt/ numri i përgjithshëm të inspektimeve	≤ 20%	20-50%	50-80%	80-100%
5	Rezultati nga marrje mostre	7	28.1	1.97	numri i shkeljeve të kërkesave ligjore të konstatuara nga analiza e mostrave/numri i mostrave të marra	≤ 20%	20-50%	50-80%	80-100%
6	Masat urgjente të marra	8	1.6	0.12	numri i masave urgjente/numri i procesverbaleve të inspektimit	≤ 20%	20-50%	50-80%	80-100%
7	Revokimet nga ankimet administrative	4	20.9	0.84	numri i vendimeve të revokuara/ numri i ankimeve administrative gjithsej	80-100%	50-80%	20-50%	≤ 20%
8	Revokime nga vendime të gjykatës	4	26.8	1.07	numri i vendimeve të rëzuara/numri i ankimeve gjyqësore gjithsej	80-100%	50-80%	20-50%	≤ 20%
9	Dënime administrative të vendosura	4	14.6	0.58	numri i dënimeve administrative të vendosura (ndjekje penale)/ numri i procesverbaleve të inspektimit	≤ 20%	20-50%	50-80%	80-100%
10	Shkelje e procedurës së inspektimit	10	1.3	0.13	numri i revokimeve për shkak të shkelesës së procedurës së inspektimit/numri i ankimeve gjithsej	80-100%	50-80%	20-50%	≤ 20%
11	Respektimi i vendit të inspektimit	3	-	-	numri i inspektimeve të kryera jo në vendin e përcaktuar në autorizim/ numri i inspektimeve gjithsej	80-100%	50-80%	20-50%	≤ 20%
12	Dënime administrative të ekzekutuara	2	25.3	0.51	numri i dënimeve administrative kryesore apo plotësuese të ekzekutuara/ numri i dënimeve administrative gjithsej	≤ 20%	20-50%	50-80%	80-100%
13	Numri i inspektimeve të kryera	2	90.4	1.81	numri i inspektimeve të kryera/ numri i inspektimeve të planifikuara	≤ 20%	20-50%	50-80%	80-100%
14	Dënime administrative gjoba në vlerë absolute	2	19.1	0.38	shuma absolute e gjobave/ të ardhura gjithsej	≤ 20%	20-50%	50-80%	80-100%
15	Rregullsia e dokumentimit të procesit të inspektimit	10	0.1	0.01	numri i inspektimeve me shkelje të ndëshkuara me ecuri disiplinore për inspektorët/ numri i inspektimeve gjithsej	80-100%	50-80%	20-50%	≤ 20%
16	Etika dhe sjellja e inspektorëve shtetërorë	4	-	-	numri i inspektorëve me shkelje të etikës/numri i inspektorëve gjithsej	80-100%	50-80%	20-50%	≤ 20%
	<b>Treguesit specifikë e vlerësimit të veprimtarisë inspektuese</b>								
	Treguesi i objektivit strategjik apo vjetor I				Kriteri i matshëm i vlerësimit				
1	Treguesi i objektivit strategjik apo vjetor II				Kriteri i matshëm i vlerësimit				

Tab.2: Të dhëna mbi inspektimet sipas fushë veprimtarive të ISHMT-së, viti 2022

Sektori/grup produktet	Numër inspekt. në total	Nr inspekt. të programuara	Nr.inspektimesh të pabarazgusura	Gjoha	Pararalajmërim	Masa Urgjente	Masa administrative total	Numër produktesh të kontrolluara	Numër produktesh jo në konformitet
<b>Sektori I Inspektimit Metrologjik</b>	<b>1042</b>	<b>979</b>	<b>63</b>	<b>40</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>40</b>	<b>4495</b>	<b>43</b>
Parapaketim	401	403	0	9	0	0	9	2279	14
Instrumenta matëse në përdorim	635	573	63	31	0	0	31	2210	29
Instrumenta matëse që hidhen në treg	6	3	0	0	0	0	0	6	0
<b>Sektori I Produkteve Elektrike</b>	<b>321</b>	<b>317</b>	<b>4</b>	<b>48</b>	<b>2</b>	<b>17</b>	<b>67</b>	<b>1108</b>	<b>79</b>
<b>Sektori I Produkteve Mekanike</b>	<b>356</b>	<b>292</b>	<b>64</b>	<b>45</b>	<b>60</b>	<b>11</b>	<b>116</b>	<b>887</b>	<b>396</b>
Ashensore	309	245	64	44	59	11	114	735	381
PMP	11	11	0	0	0	0	0	40	5
Makineri	36	36	0	1	1	0	2	112	10
<b>Sektori Kimik dhe Sig. Përgjithshme</b>	<b>376</b>	<b>333</b>	<b>43</b>	<b>43</b>	<b>6</b>	<b>10</b>	<b>59</b>	<b>4569</b>	<b>330</b>
Lodra	53	49	4	9	0	6	15	574	53
Mbrojtja e konsumatorit	155	127	28	15	6	2	23	2669	213
Siguria e përgjithshme	16	12	4	1	0	2	3	109	7
Detergjente	70	70	0	5	0	0	5	362	17
Tekstil	57	52	5	12	0	0	12	450	38
Veshje këmbë	23	23		0	0	0	0	403	0
Qese plastike	2	0	2	1	0	0	1	2	2
<b>Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve</b>	<b>2095</b>	<b>1921</b>	<b>174</b>	<b>176</b>	<b>68</b>	<b>38</b>	<b>282</b>	<b>11059</b>	<b>848</b>
<b>Sektori i të Drejtave të Autorit</b>	<b>350</b>	<b>333</b>	<b>17</b>	<b>38</b>	<b>6</b>	<b>0</b>	<b>44</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Programe kompjuterike	173	163	10	14	1	0	15		
Shtepi botuese, fotokopje, librari	65	65	0	0	0	0	0	0	0
Vepra audio-vizuale	56	55	1	14	0	0	14	0	0
Inspektim OSHMA(Radio+Kabllor)	50	50	0	6	5	0	11	0	0
Pirateri	6		6	4	0	0	4	0	0
<b>Sektori I Pronësisë Industriale</b>	<b>107</b>	<b>68</b>	<b>39</b>	<b>27</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>29</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Drejtoria e Pronësisë Intelektuale</b>	<b>457</b>	<b>401</b>	<b>56</b>	<b>65</b>	<b>6</b>	<b>2</b>	<b>73</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Çmimi i karburanteve sipas Bordit të Transparencës	17	0	17	17	0	0	17	0	0
<b>TOTALI</b>	<b>2569</b>	<b>2322</b>	<b>247</b>	<b>258</b>	<b>74</b>	<b>40</b>	<b>372</b>	<b>11059</b>	<b>848</b>

Tabela 3: Realizimi i Planit të inspektimeve sipas sektorëve, viti 2022

Sektori/grup produktet	Numër inspektimesh Planifikuar	Inspektime realizuar	%
Sektori I Inspektimit Metrologjik	1035	1042	101%
Sektori I Produkteve Elektrike	345	321	93%
Sektori I Produkteve Mekanike	414	356	86%
Sektori Kimik dhe Sig. Përgjithshme	552	376	68%
<b>Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve</b>	<b>2346</b>	<b>2112</b>	<b>90%</b>
Sektori i të Drejtave të Autorit	690	350	<b>51%</b>
Sektori i Pronësisë Industriale	0	107	<b>100%</b>
<b>Drejtoria e Pronësisë Intelektuale</b>	<b>690</b>	<b>457</b>	<b>66%</b>
<b>TOTALI</b>	<b>3036</b>	<b>2569</b>	<b>85%</b>

**Tabela 4: Numri i gjobave dhe të ardhurave nga gjobat, viti 2022**

	Numër gjobash	Vlera (Lekë)	Të ardhurat nga gjobat
Gjopa nga sistemi	215	70,320,000	
Gjopa të vendosura manualisht <sup>6</sup>	43	8,920,000	
<b>Total</b>	<b>258</b>	<b>79,240,000</b>	<b>15,140,015</b>

<sup>6</sup> Gjobat nuk janë të pasqyruara në sistemin e-inspektimi për periudhën e mosfunksionimit të sistemit për shkak të hakerimit kibernetik